

## REKOMANDIMET

### Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

#### Grupi i Punës I (Gjyqësori dhe të drejtat themeltare) Sesioni 2, Tema: E drejta e pronës në kuadër të kapitullit 23 22 dhjetor 2022

- *Procesi në Shqipëri për regjistrimin dhe dixhitalizimin mbi të dhënat kadastrale ka filluar por ende nuk ka përfunduar. Siç pohon raporti i Komisionit Europian për vitin 2022, vlerësohet se afërsisht 80% e të dhënave mbi pronat e regjistruara janë të pasakta dhe pothuajse 10% e territorit të vendit mbetet i paregjistruar. Ky proces duhet të përshpejtohet dhe duhet të finalizohet pasi është thelbësor për transparencën e plotë të këtyre të dhënave, në mbrojtjen e të drejtës së pronës dhe duke shkuar më tej në procesin e kompensimit dhe gjithashtu në luftën kundër korrupsionit.*
- *Korrupsioni në këtë sektor mbetet aktiv dhe një çështje problematike. Masat dhe përpjekjet duhet të zbatohen kundër kësaj dukurie. Këshillohet që regjistri kadastral të jetë plotësisht transparent dhe i aksesueshëm për publikun dhe grupet e interesit.*
- *Transparenca duhet të jetë qëllimi kryesor kur bëhet fjalë për trajtimin e të drejtave të pronës ndërsa mjetet e përdorura në këtë drejtim mund të ndryshojnë dhe mund të përdoren në bazë të objektivave dhe procesit. Këto mjete mund të përfshijnë publikimin dhe lirinë e informacionit bazuar në kuadrin legjislativ lidhur me regjistrin kadastral dhe të dhënat, qeverinë e hapur dhe të përgjegjshme dhe mbrojtjen e sinjalizuesve lidhur më së shumti me luftën kundër korrupsionit.*
- *Megjithatë, kjo hapje dhe publicitet duhet të marrë në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale dhe duhet të përputhet me legjislacionin kombëtar mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe të parimeve të GDPR. Në këtë kontekst, disa të dhëna sensitive nuk duhet të jenë publike për të gjithë, por vetëm për personat e interesuar. Rasti i Sllovakisë, është se numri i lindjes (numri unik i identifikimit të një personi të caktuar në lindje) dhe çmimi i pronës janë në dispozicion vetëm për personat e interesuar, e njëjta gjë është për dokumentet në mbledhjen e veprave të cilat*

*mund të jenë në dispozicion vetëm për pronarët e pronës, paraardhësit ligjorë ose pasuesit.*

- *Regjistri kadastral online ose/dhe portali rekomandohet të jetë i arritshëm për të gjithë dhe shërbimet e ofruara të jenë falas për të gjithë pa kosto shtesë. Parimi i publikimit është themelor me qëllim që të mbrohen të drejtat e pronës dhe në këtë drejtim ul stimujt për korrupsion. Gjithkush duhet të ketë të drejtën të shikojë kadastrën dhe mund të marrë ekstrakte, skica ose kopje të dokumenteve të ndryshme. Megjithatë, duhet të ketë disa përjashtime kur vjen puna te të dhënat dhe dokumentet më sensitive, që duhet të jenë në dispozicion vetëm për personat e drejtpërdrejtë të interesuar.*
- *Duke qenë se kuadri legjislativ duhet të përditësohet më tej, të përputhet me legjislacionin e BE-së dhe të jetë më gjithëpërfshirës me më shumë akte zbatuese, rekomandohet nga ana tjetër që ky legjislacion duhet të jetë para së gjithash i zbatueshëm me të gjitha masat dhe nga institucionet e nevojshme. Në këtë drejtim duhen marrë në konsideratë aspektet praktike të kësaj çështjeje si çështjet logjistike dhe teknike, besueshmëria e të dhënave, koordinimi midis autoriteteve etj.*
- *Në portalin e regjistrimit online rekomandohet të merren masat e nevojshme me qëllim të administrimit dhe përditësimit të një regjistri të tillë. Në mënyrë që të mos krijohet barrë administrative gjatë punës dhe funksionimit në këtë regjistër, duhet të planifikohen burimet administrative dhe financiare.*
- *Gjithashtu rekomandohet që ky regjistër të ofrohet në të paktën dy gjuhë (gjuha kombëtare -shqip në rastin e vendit tonë dhe në gjuhën angleze).*
- *Amendamentet e kuadrit legjislativ duhet të merren në konsideratë me qëllim që të përditësohet në mënyrë të rregullt portali, me të gjitha të dhënat dhe informacionin e nevojshëm në përputhje me amendamente të tilla.*